



Unë jam Dimam ibn Thalebe nga fisi i Sad ibn Bekrit

Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: "Teksa një ditë rrinim ulur me Profetin ﷺ në xhami, hyri një burrë hipur në deve, i cili, pasi e uli dhe e lidhi devenë, pyeti: "Cili prej jush është Muhamedi?" Profeti ﷺ ishte në mesin tonë, i mbështetur në krah. I thamë: "Ja, ky burri i bardhë (fytyrëndritur), që po rri mbështetur." O nipi i Abdulmutalibit, - iu drejtua njeriu. - "Urdhëro", - tha Profeti ﷺ. - Do të të pyes për diçka të madhe, kështu që do të jem i rëndë në pyetje, andaj mos m'u hidhëro. - "Pyet çfarë të duash", - i tha Profeti ﷺ. Po të bëj be në Zotin tënd dhe në të atyre para teje, a me të vërtetë Allahu të ka dërguar te të gjithë njerëzit? Profeti ﷺ tha: "Po, betohem në Allahun se ashtu është!" - Po të bëj be në Allahun, a Allahu të ka urdhëruar t'i falësh pesë namaze gjatë ditës e natës? - "Po, betohem në Allahun se ashtu është." - Po të pyes, duke të bërë be në Allahun, a Allahu të ka urdhëruar ta agjërosh këtë muaj të vitit? - pyeti ai. "Po, betohem në Allahun se ashtu është", - iu përgjigj Profeti ﷺ. - Po të bëj be në Allahun, a Allahu të ka urdhëruar ta marrësh zekatin prej të pasurve tanë dhe t'ua ndash të varfërve tanë? - "Po, betohem në Allahun se ashtu është." Burri në fjalë tha: "Besova në tërë atë në të cilën ti thërret. Jam dërguar nga populli im. Unë jam Dimam ibn Thalebe nga fisi i Sad ibn Bekrit."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Enes ibn Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se, teksa sahabët ishin ulur me Profetin ﷺ në xhami, një burrë i hipur në deve, pasi e uli dhe e lidhi devenë, i pyeti: "Cili prej jush është Muhamedi?" Profeti ﷺ ishte në mes të njerëzve dhe i thamë: "Ja, ky burri i bardhë (fytyrëndritur), që po rri mbështetur." O nipi i Abdulmutalibit, - iu drejtua ky burrë. Profeti ﷺ i tha: "Të dëgjova dhe pyet, se do të të përgjigjem." Ky burrë i tha Profetit ﷺ: "Do të të pyes për diçka të madhe, kështu që do të jem i rëndë në pyetje, andaj mos m'u hidhëro." Pra, mos u zemëro me mua dhe mos u ngushto! Profeti ﷺ i tha: "Pyet çfarë të duash." Ai tha: "Po të bëj be në Zotin tënd dhe në të atyre para teje, a me të vërtetë Allahu të ka dërguar te të gjithë njerëzit?" Profeti ﷺ tha: "Po, betohem në Allahun se ashtu është", duke pohuar sinqeritetin e tij. Ky burrë i tha: "Po të bëj be në Allahun, a Allahu të ka urdhëruar t'i falësh pesë namaze gjatë ditës e natës?" Këto janë namazet obligative. Profeti ﷺ tha: "Po, betohem në Allahun se ashtu është." Ai tha: "Po të pyes, duke të bërë be në Allahun, a Allahu të ka urdhëruar ta agjërosh këtë muaj të vitit?" Pra, muajin Ramazan. Profeti ﷺ: "Po, betohem në Allahun se ashtu është." Ai tha: "Po të bëj be në Allahun, a Allahu të ka urdhëruar ta marrësh sadakanë prej të pasurve tanë dhe t'ua ndash të varfërve tanë?" Pra, zekatin. Profeti ﷺ tha: "Po, betohem në Allahun se ashtu është." Dimami hyri në Islam dhe i tha Profetit ﷺ se do ta thërriste popullin e tij në Islam. Pastaj ai u prezantua se ishte Dimam ibn Thalebe nga fisi i Sad ibn Bekrit.

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY

